3 2/18

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**NR.** 3211/B

## VENDIM
## PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me date 13.09.2004, une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit Gjovalin Shtjefni , me cilesine e drejtorit te shoqerise "MILIS BRIC" SHA i cili kerkon te regjistroje si person juridik shoqerine anonime « MILIS BRICK » SHA dhe ;

## KONSTATOVA:

Se kerkuesi kerkon te regjistroje si person juridik shoqerine anonime « MILIS BRICK » SHA, me aksioner Zef Shtjefni, Shpetim Shijaku dhe Sokol Rakaj. Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte ne fushen e prodhimit te materialevete ndertimit, sidomos atoqeramike, ndertime te ndyshme, blerje e shitje mallrash me qellim fitimi etj.

Selia e shoqerise do te jete ne Fushe Kruje te rrethit Kruje.
Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 35 vjet.
Kapitali themeltar i shoqerise eshte 31.250.000 leke.
Drejtor ekzekutiv z. Gjovalin Shtjefni.
Keshilli Mbikqyres perbehet nga :
Kryetari - Shpetim Shijaku
Anetare - Arta Shtjefni
Anetare - Vojsava Raka
Eksperte kontabel znj, Ajeta Shkembi.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

## VENDOSA:

Te regjistroje si person juridik shoqerine anonime « MILIS BRICK » SHA, me aksioner Zef Shtjefni, Shpetim Shijaku dhe Sokol Rakaj. Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte ne fushen e prodhimit te materialevete ndertimit, sidomos atoqeramike, ndertime te ndyshme, blerje e shitje mallrash me qellim fitimi etj.

Selia e shoqerise do te jete ne Fushe Kruje te rrethit Kruje.
Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 35 vjet.
Kapitali themeltar i shoqerise eshte 31.250.000 leke.
Keshilli Mbikqyres perbehet nga :
Kryetari - Shpetim Shijaku
Anetare - Arta Shtjefni
Anetare - Vojsava Raka
Eksperte kontabel znj, Ajeta Shkembi.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

**G J Y Q T A R E**
ARIANA CACO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr.32118/1 Vendimi

VENDIM

I GJYQTARES SE VETME

Sot me date 24.11.2004 une gjyqtarja e Gykates se Shkalles se Pare Tirane pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Gjovalin Shtjefni, i cili kerkon te depozitoje Vendimin nr.1, date 17.11.2004 te Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te shoqerise "MILIS BRIK" sha dhe;

KONSTATOVA;

Shoqeria "MILIS BRICK" sha eshte e regjistruar si person juridik me numer vendimi 32118, date 13.09.2004 me aksionere themelues te kesaj shoqerie Zef Shtjefni me 45 % te aksioneve, Shpetim Shijaku me 35 % te aksioneve dhe Sokol Rakaj me 20 % te aksioneve.

Me vendimin te Asamblese se Jashtezakonshme date 17.11.2004 eshte miratuar shitja e aksioneve te aksionerit z. Sokol Rakaj dy aksionereve te tjere z. Zef Shtjefnit i cili posedon 55 % te aksioneve me nje vlere prej 137.500 (njeqind e tridhjeteshtatemije e peseqind) euro dhe z. Shpetim Shijaku qe posedon 45 % te aksioneve me nje vlere 112.500 (njeqind e dymbedhjetemije e peseqind) Euro.

Gjithashtu eshte vendosur ndryshimi ne Keshillin Mbikqyres te shoqerise MILIS BRICK SHA ne vend te Vojsava Rakaj emerohet Vera Shijaku.

Kerkuesi kerkon te depozitohet vendimi i Asamblese se Jashtezaakonshme te aksionereve dhe te behen ndryshimet perkatese ne Skeden e kesaj shoqerie.

Per sa me siper, nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit 7667 , date 19.11.1992 " Per regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhet te plotesohen ne te",

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses per depozitimin e vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme nr.1, date 17.11.2004 te shoqerise "MILIS BRICK" SHA .

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregtar, ne kollonen nr.4,5 duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

BLERINA MUÇA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 32118/2 Vendimi

**VENDIM**

**I GJYQTARES SE VETME**

Sot me daten 20.06.2006 une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Xhavit Mamaçi i cili kerkon te depozitoje Vendimin Nr 1 date 24.03.2006 te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. dhe Vendimin Nr 2 date 24.03.2006 i Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te Shoqerise dhe:

**KONTSTATOVA se:**

Shoqeria "MILIS BRICK"sh.a. eshte e rregjistruar si person juridik me numer vendimi 32118 date 13.09.2004 me aksionere themelues te kesaj shoqerie z, Zef Shtjefni me 45% te aksioneve, Shpetim Shijaku me 35% te aksioneve dhe Sokol Rakaj me 20% te aksioneve.

Me Vendimin Nr 1 te Asamblese se Jashtezakonshme date 17.11.2004 eshte miratuar shitja e aksioneve te aksionerit Sokol Rakaj dy aksionereve te tjere z.Zef Shtjefni i cili posedon 55% te aksioneve me nje vlere 137,500(njeqindetridhjeteshtate mije e peseqind) euro dhe z. Shpetim Shijaku qe posedon 45% te aksioneve me nje vlere 112.500( njeqind e dymbedhjetemije epeseqind) euro.

Gjithashtu eshte vendosur ndryshimi ne Keshillin Mbikqyres te Shoqerise "MILIS BRICK" sha. ne vend te Vojsava Rakaj emerohet Vera Shijaku.

Me Vendimin Nr 1 te Keshillit Mbikqyres date 24.03.2006 eshte vendosur :

1- Lirohet nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a. z. Gjovalin Shtjefni.

2-Emerojme Drejtor Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK"sh.a. z.Xhavit Mamaçi duke i dhene te gjitha kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a.

Me vendimin Nr 2 date 24.03.2006 te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. eshte Vendosur

1- Rritjen e Kapitalit themeltar te Shoqerise"MILIS BRICK" sh.a.

# AKT THEMELIMI

# I SHOQERISE AKSIONARE MILIS BRICK

Me cilesine e aksionereve themelues Zef Shtjefni lindur me 1960 ne Lezhe dhe banues ne Lezhe,Shpetim Shijaku,lindur me 1962 ne Fushe Kruje dhe banues ne Fushe Kruje dhe Sokol Raka , lindur me 1979 ne Tirane dhe banues ne Tirane vendosim sot dt. 04.09.2004 te themelojme Sh.A.Milis Brick, si shoqeri tregtare e tipit aksionar,sipas ligjit " Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise".

**NENI 1**

Qellimi i krijimit te shoqerise Milis Brick Sh.A.eshte ushtrimi i veprimtarise ekonomike tregtare ne fushen e prodhimit te materialeve te ndertimit,sidomos ato qeramike,ndertime te ndryshme,blerje e shitje mallrash te ndryshme me qellim fitimi etj.

**NENI 2**

Selia e shoqerise do te jete ne Fushe Kruje.

**NENI 3**

Kapitali themelor i shoqerise perbehet nga kontributi ne euro ose lek i aksionereve themelues te shoqerise dhe perben vleren minimale te kapitalit te shoqerise ,i cili do te derdhet brenda 15 ditesh nga regjistrimi i ketij akti ne regjistrin tregtar ne Gjykaten e Tiranes .Kapitali themelor fillestar do te jete 250 000 euro ose ekujvalenca ne 31 250 000 leke shqiptare.

**NENI 4**

Kapitali themelor eshte i ndare ne 100 aksione.Posedimi i aksioneve nga aksioneret ne perqindje eshte si me poshte:

1.Zef Shtjefni 45% me vlere 112 500 euro.
2.Shpetim Shijaku 35% me vlere 87 500 euro.
3.Sokol Raka 20% me vlere 50 000 euro.

Kjo pjesemarrje mund te ndryshoje ne mbledhjen e jashtezakonshme te asamblese per zmadhimin e kapitalit qe do te behet me 30 tetor 2004,ashtu sic eshte parashikuar ne nenin 9 te statutit te kesaj shoqerie te neshkruar prej tre aksionereve themelues.

**NENI 5**

**Organet e Sh.A.Milis Brick.**

**1.Asambleja e aksionereve**

Perbehet nga tre aksionere themelues:Zef Shtjefni me 45% te aksioneve,Shpetim Shijaku me 35% dhe Sokol Raka me 20% te aksioneve.
-Asambleja e zakonshme thirret nje here ne vit per miratimin e ushtrimit te vitit,palnifikimin e investimeve per vitin ne vazhdim,zgjedhjen e Drejtorise dhe Keshillit Mbikqyres, kur u mbarojne mandatet dhe marrjen e gjithe vendimeve te tjera administrative te nevojshme.Asambleja thirret nga Drejtori,Keshilli Mbikqyres ,eksperti kontabel apo aksioneret qe posedojne te pakten 10% te aksioneve.Thirrja behet me shkrim brenda 15 diteve, duke njoftuar edhe rendin e dites.Asambleja quhet e vlefshme kur ne te marr pjese te pakten 51% e aksioneve.
-Asambleja e jashtezakonshme thirret ne cdo kohe.Thirrjen e saj e kane te drejte aksioneret qe posedojne te pakten 10% te aksioneve,Drejtori,Kryetari i Keshillit Mbikqyres,eksperti kontabel.Asambleja e jashtezakonshme ka te drejten e marrjes se te gjitha vendimeve pa perjashtuar asnje ne lidhje me veprimtarine e shoqerise.Kush e therret asamblene e jashtezakonshme ben edhe pergatitjen e materialeve dhe percakton rendin e dites.

**2.Drejtoria**

Zgjidhet apo ndryshohet nga Asambleja me propozim te Keshillit Mbikqyres.Drejtoria do te perbahet nga Drejtori dhe nga dy deri ne shtate anetare.Drejtor u zgjodh z. Gjovalin Shtjefni ,lindur me banues ne Lezhe. Drejtoria ka te gjitha funksionet e administrimit te veprimtarise se shoqerise dhe te perfaqesimit te saj para te treteve dhe para ligjit.Drejtoria vepron ne baze te vendimeve qe marrin Asambleja e aksionereve dhe Keshilli Mbikqyres.Drejtoria ka per detyre informimin e Keshillit Mbikqyres me shkrim nje here ne tre muaj per ecjen e veprimtarise dhe Asamblene nje here ne vit ,apo sa here te kerkoje ajo.Drejtoria kontrollohet dhe jep llogari para Keshillit Mbikqyres cdo tre muaj.Ajo pergatit thirrjet e rregullta te Asamblese se zakonshme , pergatit rendin e dites dhe gjithe materialet e tjera te nevojshme.Drejtoria ka mandat tre vjecar te rinovueshem.Drejtor i pare i shoqerise u zgjodh Gjovalin Shtjefni.

**3.Keshilli Mbikqyres**

Keshilli Mbikqyres zgjidhet dhe shkarkohet nga Asambleja.Perbahet nga tre veta.Ai ka nje kryetar dhe dy anetare.Secilit prej tyre i ngarkohen detyra konkrete mbikqyrje nga asambleja.Keshilli mbikqyres kontrollon gjithe punen e Drejtorise.Anetaret e Drejtorise nuk mund te jene anetare te Keshillit mbikqyres dhe anasjelltas.Keshilli mbikqyres therret ne raport

Drejtorine dhe raporton vete ne Asamble.Mandati i Keshillit mbikqyres eshte tre vjecar me te drejte rizgjedhje.Ne Keshillin e pare Mbikqyres u zgjodh kryetar Shpetin Shijaku dhe anetar Arta Shtjefni e Vojsava Raka.

**NENI 6**
Kandidatet per eksperte kontabel propozohen nga drejtoria,Keshilli Mbikqyres dhe zgjidhen apo shkarkohen nga Asambleja.

**NENI 7**
Organizimi dhe hapja e filialeve te tjera brenda apo jashte vendit behet nga Drejtoria me vendim te Asamblese.

**NENI 8**
Zgjedhja e personelit teknik behet nga Drejtoria dhe miratohet nga Keshilli Mbikqyres.

**NENI 9**
Pagat e Drejtorise,personelit teknik dhe niveli i pagave te punonjesve caktohen nga Asambleja ose me rekomandim te saj nga Keshilli Mbikqyres.Pagat e vecanta te punonjesve caktohen nga Drejtoria.

**AKSIONERET THEMELUES TE MILIS BRICK SH.A.**

**1.ZEF SHTJEFNI** **2.SHPETIM SHIJAKU** **3.SOKOL RAKA**

# STATUTI
# I SHOQERISE AKSIONARE MILIS BRICK

Sot dt. 04.09.2004
**1.Zef Shtjefni** lindur me 1960 ne Lezhe dhe banues ne Lezhe,
**2.Shpetim Shijaku** lindur me 1962 ne Fushe Kruje e banues ne F. Kruje,
**3.Sokol Raka** lindur me 1979 ne Tirane e banues ne Tirane,
vendosem te hartojne e nenshkruajme kete satatut si vijon:

## KAPITULLI I PARE
## Emri,vendndodhja,qellimi,kohezgjatja.

### NENI 1
U vendos qe shoqeria te emrohet MILIS BRICK SH.A. ne perputhje me te drejtat qe garanton Kodi Tregtar i Republikes se Shqiperise, i cili rregullon poziten juridike te themeluesve,oganizimin , objektin e veprimtarise se shoqerise dhe ceshtejeve te tjera me rendesi per aktivitetin e saj.

### NENI 2
Shoqeria bazohet ne pronesine private te aksionereve ne shoqeri dhe regjistrimin e tyre ne regjistrin tregtare te Gjykates se Tiranes.

### NENI 3
Shoqeria ka statusin e personit juridik.

### NENI 4
Vendodhja dhe selia e shoqerise eshte ne Fushe Kruje Shqiperi.

### NENI 5
Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte deri me 31 dhjetor 2037 dhe rinovohet automatikisht nese Asambleja e jashtezakonshme e aksionereve nuk vendos ndryshe.

### NENI 6
Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte prodhimi dhe shitja e materialeve te ndertimit,qeramikes,blerja dhe shitja me qellime fitimi i cdo lloj malli te ligjshem,turizem,aktivitet minerar etj.,ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**NENI 7**
Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne Shqiperi.Drejtoria,nese autorizohet nga Asambleja,mund te hape filiale edhe ne qytete apo shtete te tjera,ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendeve perkatese.

**NENI 8**
Shoqeria ushtron veprimtarine e saj prodhuese e tregtare duke u bazuar ne parimet e likujditetit,sigurise e fitimit.

**KAPITULLI I DYTE**
**Kapitali**

**NENI 9**
Kapitali themelor fillestar i shoqerise u vendos te jete 250 000 euro ose ekujvalenca ne 31 250 000 leke shqiptare i nenshkruar si me poshte:Zef Shtjefni 45% me 112 500 euro,Shpetim Shijaku 35% me 87 500 euro dhe Sokol Raka 20% me 50 000 euro.Kapitali themelor fillestar perfaqeson vleren e 100 aksioneve.Te gjithe aksioneret qe perfaqesojne 100% te aksioneve vendosen qe te therrasin me 30 tetor 2004 mbledhjen e Asamblese se jashtezakonshme te Milis Brick Sh.A. per domosdoshmerine e rritjes se kapitalit ne sipereremarrjen e nisur,Asamble e cila mund te ndryshoje edhe perqindjen e posedimit te aksioneve nga aksioneret, si me poshte:a).Ne kushtet e sigurimit te kreditimit nga bankat te shoqerise,perfitimi prej kredise nga ana e aksionereve do te jete ne kuota te barabarta,por perqindja e posedimit te aksioneve prej tyre nuk do te ndryshoje,pasi do te behet kompensimi sipas perqindjeve me kontributet e secilit ne kash.Vlera e nje aksioni do te rritet ne proporcion te drejte me shtimin e kapitalit ,ndersa perqindja e posedimit te aksioneve nga aksioneret do te mbetet e pandryshuar.b).Nese asistenca nga bankat nuk do te jete e mundur,atehere shtimi i kapitalit dhe vleres se aksioneve nga 250 000 euro ne 2 168 000 euro do te behet me kontributet e vete aksionereve si vijon: Zef Shtjefni do te plotesoje dhe posedoje 50% te aksioneve me vlere 1 084 000 euro.Shpetim Shijaku do te plotesoje dhe posedoje 40% te aksioneve me 867 200 euro.Sokol Raka do te plotesoje dhe posedoje 10% te aksioneve me vlere 216 800 euro.

Shoqeria do te ruaj formen klasike me 100 aksione.Ne kete rast nje aksion do te jete i barabarte me 21 680 euro.Nje aksion eshte i barabarte me nje vote ne Asamble.

Kryetari i Keshillit Mbikqyres dhe Drejtori ndjekin procedurat e depozitimit ne nr. te llogarise se shoqerise te shumave perkatese nga aksioneret.Kapitali themelor fillestar do te derdhet brenda 15 nga data e regjistrimit te shoqerise ne Gjykate.Shtesa e dyte per rritjen e kapitalit ne 1 000 000 euro do te derdhet nga aksioneret sipas perqindjeve perkatese deri me 31 janar 2005.Shtesa e trete prej 1 168 000 eurosh do te derdhet deri me 31 dhjetor 2005 me keste sipas fazave te planit te realizimit te investimeve.

Kryetari i keshillit mbikqyres dhe Drejtori ruajne konfermat e derdhjes se kapitalit nga aksioneret dhe u leshojne aksionereve edhe vertetime perkatese.

**NENI 10**

Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon aksioneret te zhvillojne biznese ne shoqeri te tjera.

**NENI 11**

Aksioneret kane te gjithe te drejtat qe parashikon legjislacioni shqiptar per shoqerite aksionare dhe kryesisht:

-Te marre pjese ne asamble drejteperdrejte dhe i perfaqesuar me prokure,ne perputhje me nenet e ketij statuti.

-Te jete pjesemarres i rezultateve dhe veprimtarise se shoqerise ne cdo lloj forme ne perputhje me kete statut.

-Te jete i informuar mbi gjendjen e llogarive dhe ti kontrolloje ato kurdo.

-Te beje propozime dhe te marre pjese ne vendimet e asamblese,sic parashikon ligji dhe ky statut.

**NENI 12**

Aksioneri ka te gjithe detyrimet qe parashikon legjislacioni shqiptar si:

-Te derdhe ne llogarine bankare ose arken e shoqerise vleren e kapitalit te nenshkruar ne afatin e percaktuar ne kete statut dhe akt-themelim.

-Te informoje shoqerine per ecurine e veprimtarise e shoqerise.

-Te beje ceshte e mundur,sipas funksioneve qe ka ,per te miren e rezultateve te shoqerise.

**NENI 13**

Cdo aksioner lirisht mund te trasferoje aksionet e tij,plotesisht ose pjeserisht personave te tjere edhe jashte shoqerise.Ne rastin e fundit aksioneret kane te drejten e parablerjes sipas marreveshjeve perkatese.Kush deshiron te leshoje aksionet duhet te vere ne dijeni me shkrim aksioneret e tjere beshke me oferten perkatese.Aksioneret kane te drejte qe brenda 30 ditesh te

nenshkruajne kontreten e blerjes.Nese kalon kjo periudhe pa pergjigje,ose pa u paguar vlera perkatese e aksioneve ne shitje,shitesi mund ti shese ato lirisht jashte shoqerise.Nese te gjithe aksioneret deshirojne ti blejne aksionet ne shitje,atehere ato blejne ne perputhje me perqindjet e aksioneve qe ata posedojne ne shoqeri,nese nuk ka marreveshje tjeter mes tyre.

**NENI 14**
Pronesia e aksionereve i perket shoqerise, e cila e perdor per te arritur objektin e saj shoqeror.

**NENI 15**
Shoqeria mund te bleje te mira materiale dhe mund te shfrytezoje te drejta.Mund te jape te mirat e saj materiale ne garanci dhe mund te perdore vlerat e saj financiare sipas statutit.Borxhet eventuale qe mund te lindin,mbulohen me mjetet ekzistuese,me kontributin e aksionereve permes shtimit te kapitalit themelor,permes huave,kredive bankare etj.

**KAPITULLI I TRETE**

**NENI 16**
Asambleja rregullisht paraqet universalitetin e aksionereve dhe vendimeve te tyre te marra ne perputhje me legjislacionin dhe kete statut dhe detyron te gjithe aksioneret.Asambleja ka te gjitha fuqite e zakonshme dhe jashtezakonshme pa perjashtuar asnje.

**NENI 17**
Asambleja e zakonshme dhe e jashtezakonshme thirren nga Drejtoria,nga nje apo disa aksionere qe posedojne te pakten 10% te aksioneve,nga eksperti kontabel me leter rekomande 15 dite para,se bashku me rendin e dites.Kush therret asamblene pergatit rendin e dites dhe gjithe materialet per te.Do te jene te vlefshme dhe asamblete e thirrura jo si me siper,por qe te jete prezent gjithe kapitali themelor.

**NENI 18**
Mund te nderhyjne ne asamble te gjithe aksioneret.Cdo aksioner ka te drejte vendimmarrje ne perputhje me votat qe i garantojne aksionet qe posedon ne shoqeri.Vendimet e Asamblese se zakonshme merren me 50 plus 1 perqind e votave qe perfaqesojene 100 % te aksioneve .Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme merren me 67% te votave qe perfaqesojen 100% te aksioneve.Asambleja e jashtezakonshme,ka te drejte te ndryshoje statutin,te

beje celjen e filialeve ne qytete e shtete te tjera,ka te gjitha te drejtat pa perjashtuar asnje,pervec rastit te mbylljes se aktivitetit dhe shitjes totale te pronesise se shoqerise, ku kerkohet miratimi nga te gjithe aksioneret qe perbejne 100% te kapitalit.

**NENI 19**
Cdo aksioner qe ka te drejte te nderhyje ne asamble mund te perfaqesohet me prokure nga nje person i autorizuar prej tij.

**NENI 20**
Asambleja kryesohet nga presidenti qe zgjidhet me shumice te zakonshme votash ne fillim te mbledhjes.Presidenti cakton nje sekretar per mbajtjen e akteve.

**NENI 21**
Vendimet e asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme jane te vlefshme kur merren me mazhorance votash,sic percakton ky statut.

**NENI 22**
Vendimet e asamblese mbahen ne procesverbal te vecante dhe firmosen nga presidenti dhe sekratari.

## KAPITULLI I KATERT

**Administrimi**
**NENI 23**
Shoqeria administrohet :

a).Nga **Drejtoria** qe perbehet nga dy deri shtate anetar me mandat tre vjecar te rinovueshem.Drejtor i pare i Milis Breek Sh.A. u zgjodh z. Gjovalin Shtjefni,lindur me 1968 ne Lezhe dhe banues ne Lezhe.Eksperte kontabel u zgjodh z.Ajeta Shkembi.

b).Nga **Keshilli Mbikqyres**, i cili perbehet nga kryetari dhe dy anetar.Kopetencat e tij jane: te kontrolloje punen e Drejtorise dhe te informoje Asamblene.Gjithashtu i takojne edhe gjithe kopetencat e tjera qe i njeh ligji per Shoqerite Tregtare.Mandati i Keshillit eshte tre vjecar me te drejte rizgjedhje.Si kryetar i pare i Keshillit Mbikqyres i Milis Brick Sh.A. u zgjodh z. Shpetim Shijaku dhe anetar Arta Shtjefni e Vojsava Raka.

**NENI 24**

Drejtorise i takojne vetem aktet e zakonshme te administrimit.Drejtorit i takon perfaqesimi ligjor i shoqerise para te treteve dhe gjykimit.Ne mungese te tij ai autorizon perfaqesimin nga nje pjesetar tjeter i drejtorise apo avokat.

**NENI 25**
Kopetencat e Drejtorise jane:
-Te beje organizimin dhe administrimin e perditshem te veprimtarise.
-Te pergatise bilancet dhe tia paraqese Asamblese.
-Te therrase Asamblene dhe te pergatise rendin e dites e materialet e tjera.
-Ti beje propozime te ndryshme Asamblese.
-Cakton raportet e brendshme ne shpoqeri dhe emron kuadrin e personelin drejtues dhe percakton e kontrollon detyrat e tij.
-Vendos numurin e punonjesve dhe pagat e tyre,firmos kontratat e punes.
-Siguron zbatimin e ligjshmerise gjate ushtrimit te veprimtarise.

**KAPITULLI I PESTE**

**NENI 26**
Raportet e punes brenda shoqerise rregullohen sipas legjislacionit shqiptar te punes dhe normave te ketij statuti.

**NENI 27**
Punemarresit kane per detyre te zbatojne rregulloret e ndermarrjeve dhe kane te drejte te shperblehen sipas kontrateve per punen e kryer dhe pranuar.

**KAPITULLI I GJASHTE**

**NENI 28**
Veprimtaria vjetore e shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.Drejtoria i paraqet bilancin dhe planin e investimeve ne vazhdim Asamblese brenda tre muajve nga perfundimi i ushtrimit te vitit.Keshilli mbikqyres ben oponencen e vet per bilancin dhe planin e investimeve.Asambleja merr vedimet perkatese.

**NENI 29**
Fitimi neto pervec 5% te fondit rezerve legal,mund ti shtohen kapitalit themelor ose mund ti ndahet ortakeve sipas perqindjes se aksioneve qe posedojne,ne format qe percakton Asambleja dhe ligji.

**NENI 30**
Fitimi qe nje ortak nuk e terheq brenda pese vjetesh behet prone e gjithe shoqerise.

**KAPITULLI I SHTATE**

**NENI 31**
Ne qofte se ndodh ,ne cdo moment,per cfaredolloj shkaku shkrirja e shoqerise,Asambleja vendos menyren e likujdimit dhe cakton nje apo disa likujdatore,duke respektuar ligjet ne fuqi.

**KAPITULLI I TETE**

**NENI 32**
Shoqeria do te favorizoje rritjen ekonomike te vendit dhe zones perkatese.Drejtoria do ti jape perparesi ne perputhje me profesionet e kerkuara punesimit te njerezve me ne nevoje e vecanarisht grave dhe vajzave.

**NENI 33**
Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut,do ti referohemi legjislacionit shqiptar ne fuqi.
Ky statut hartohet ne pese kopje origjinale dhe duke u firmosur si me poshte prej aksionereve themelues shprehet vendimi dhe vullneti i tyre i lire per krijimin e Milis Brick Sh.A.

**AKSIONERET THEMELUES**

**1.ZEF SHTJEFNI 2.SHPETIM SHIJAKU 3.SOKOL RAKA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE LEZHE
Nr ..2265.. rep Nr 683 Kol

# V E R T E T I M

Sot em daten 04.09.2004 ne zyren e noterise ne Lezhe para meje Noterit Vasil Martini u paraqiten personalisht Zef Shtjefni i biri i Dedes i datelindjes 10.04.1960, me banim ne Lezhe, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikur me pasaporte, Shpetim Shijaku i biri i Sulejmanit i datelindjes 01.05.1962, me banim ne Fushe Kruje, madhior em zotesi t eplote per te vepruar, i identifikuar me paspaorte dhe sokol rakaj I biri i Gjergjit i datelindjes 02.12.1979, me banim ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar me pasaporte, te cilet kane perpiluar aktin e themelimit dhe statutin e Shoqerise " MILIS BRICK" SH.A. me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe e kane nenshkruar ne prezencen time si noter dhe une duke I gjetur ne rregull I vertetoj.

N O T E R I
VASIL Martini

REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE LEZHE

Nr 2266 Rep Nr [illegible] Kol.

# V E R T E T I M

Sot me daten 04.09.2004 ne zyren e noterise ne Lezhe une noteri Vasil Martini vertetoj se kane depozituar shumen prej 250.000(dyqind e pesedhjetemije)Euro ose ekujvalenca ne leke e tyre 31.250.0000( tridhjete e njemilion e dyqind e pesedhjetemije) leke nga Aksioneret Themelues te Shoqerise "MILIS BREEK"sh.a. Zef Shtjefni ne masen 45% me vlere 112.500 Euro, Shpetim Shijaku ne masen 35% me vlere 87.500 Euro dhe Sokol Rakaj ne masen 20% me vlere 50.000 Euro.

Kjo shume eshte Vlera e Aksioneve te Shoqerise "MILIS BREEK" sh.p.k. i depozituar prane zyres time per te vertetuar shumen e Kapitalit themelor konforme ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" neni 62 paragrafi I dyte.

Leshoj kete vertetim (deftese) per te vertetuar shumen e Aksioneve te Shoqerise "MILIS BREEK"sh.a. me qender ne Fushe - Kruje, te derdhur nga Aksioneret Zef Shtjefni, Shpetim Shijaku, Sokol Rakaj.

N O T E R I

Vasil Martini

**MILIS BRICK SH.A.**
**FUSHE KRUJE**
*Nr. 01 Prot.*

## VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE MILIS BRICK SH.A.

Ne mbledhjen e saj te jashtezakonshme te mbajtur sot dt.17.11.2004 ne seline e saj ne Fushe Kruje , Asambleja e Jashtezakonshme e Milis brick Sh.A. ku muaren pjese aksioneret qe posedojne 100% te aksioneve te kesaj shoqerie,krahas problemeve te tjera,pasi shqyrtoi realizimin e plotesimit te kapitalit themelor te shoqerise nga aksioneret sipas aksioneve te nenshkruara

**KOSTATOJ**

se ne baze te informacineve te Drejtorise dhe Keshillit Mbikqyres aksioneri Sokol Rakaj, duke mos qene ne gjendje te derdhe vleren e aksioneve te tij ne llogarine apo arken e shoqerise ne afatin e caktuar,ka ofruar dhe realizuar shitjen totale te 20% te aksioneve qe posedonte ne kete shoqeri,dy ortakeve themelues te shoqerise Milis Brick Sh.A. si vijon: Zef Shtjefnit i ka shitur 10% te aksioneve me vlere 25 000 € (njezetepese mije euro) dhe Shpetim Shijakut 10% me vlere 25 000 €(njezet e pese mije euro).

Gjithashtu Asambleja mori ne shqyrtim dhe pranoi edhe kerkesen e anetares se Keshillit Mbikqyres z.Vojsava Rakaj per tu larguar nga kjo detyre dhe miratoi sugjerimin e ketij Keshilli per zevendesimin e saj me z.Vera Shijaku.

Asambleja kostatoj se ne te dy rastet e mesiperme eshte respektuar statuti i shoqerise dhe ligjet shqiptare ne fuqi dhe per kete aresye Asambleja e Jashtezakonshme e Milis Brick Sh.A.,me njeqind per qind te votave qe perfaqesojne totalin e kapitalit themelor

**V E N D O S I**

**a).**Ti kerkoje Gjykates regjistrimin e ndryshimeve te bera ne posedimin e aksioneve ne Sh.A.Milis Brick ku pas ketij akti shitje,vlera e 100% te aksioneve ndahet mes dy aksionereve themelues si vijon:

**1.Zef Shtjefni posedon 55%**(pesedhjete e pese perqind)te aksioneve me vlere 137 500 (njeqind e tridhjete e shtate mije)euro.

**2.Shpetim Shijaku posedon 45%**(dyzet e pese perqind) te aksioneve me vlere 112 500 (njeqind e dymbedhjete mije)euro.

**b).**Ti kerkoje Gjykates regjistrimin e ndryshimeve ne Keshillin Mbikqyres te Sh.A. Milis Brick,ku ne vend te z.Vojsava Rakaj emerohet z.Vera Shijaku.

**PER ASAMBLENE E JASHTEZAKONSHME TE SH.A.MILIS BRICK**

**PRESIDENTI**
**Zef Shtjeni**

**SEKRETARI**
**Shpetim Shijaku**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERI V.MARTINI
*Nr.9142 regj.*
*Nr.925 kol.*

# KONTRATE SHITJE

Sot me dt. 17.11.2004 ne Lezhe para meje noter Vasil Martini u paraqiten palet:

**1.PALA SHITESE:** ***Sokol Rakaj***,lindur me 1979 ne Tirane dhe banues ne Tirane,aksioner ne Sh.A Milis Brick per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta qe mbante me vete dhe njohja personale.

**2.PALA BLERESE:** ***a) Zef Shtjefni***,lindur me1960 ne Lezhe dhe banues ne Lezhe,aksioner te sh.a. Milis Brick, per identitetin e te cilit u sigurova nga njohja ime personale.

***b) Shpetim Shijaku***,lindur me 1962 ne Fushe Kruje dhe banues ne Fushe Kruje,aksioner ne Sh.A Milis Brick,per identitetin e te cilit u njoha nga pasaporta qe mbante me vete.

Palet kerkuan nga une noteri redaktimin e tekstit te meposhtem te kesaj kontrate:Sokol Rakaj posedon 20% (njezet perqind) te aksioneve te Sh.A.Milis Brick me qender ne Fushe Kruje,cka vertetohet me statutin e shoqerise, aktin e themelimit dhe vendimin perkates te regjistrimit te Gjykates nr.32113,dt.13.092004.Keto aksione me vlere kapitali themelor 50 000 €(pesedhjete mije euro) te deklaruara,duke qene se nuk eshte ne gjendje financiare ti plotesoje jua shet dy ortakeve themelues te Sh.A.Milis Brick me te njejten vlere dhe ne proporcion te barabarte si vijon:10% (dhjete perqind) e me vlere 25 000 € (njezet e pese mije euro)ia shet Zef Shtjefnit qe e pranon blerjen dhe 10%(dhjete perqind) ia shet Shpetim Shijakut me vlere 25 000 €(njezet e pese mije euro),i cili po ashtu e pranon blerjen.

Me shitjen totale te aksioneve te tij Sokol Rakaj del perfundimisht nga sh.a.Milis Brick dhe permes kesaj kontrate

cveshet nga cdo detyrim ligjor ndaj kesaj shoqerie, duke obliguar aksioneret Zef Shtjefni dhe Shpetim Shijaku te plotesojen vlerat e 20 % te aksioneve (nga 10% secili) te cituar me siper ,ne Sh.A.Milis Brick deri me 30.11.2004.

Permes kesaj kontrate Zef Shtjefni dhe Shpetim Shijaku deklarojne se kane pranuar oferten dhe blerjen e ketyre aksioneve dhe se marrin persiper pergjegjesite statutore e ligjore para organeve te shoqerise per pagesen e vlerave perkatese te aksioneve te blera dhe plotesimin e kapitalit themelor te Sh.A.Milis Brick.

Palet deklarojne se cdo gje e kane bere me vullnetin e tyre te lire dhe konform statutit te shoqerise dhe ligjeve shqiptare ne fuqi,cka konfirmohet edhe nga une noteri.Per vertetimin e sa siper ftova palet ne prezencen time te nenshkruajne kete kontrate si me poshte.

**PER PALEN SHITESE**
**Sokol Rakaj**

**PER PALEN BLERESE**
**Zef Shtjefni**
**Shpetim Shijaku**

NOTERI
VASIL GJ. MARTINI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "MILIS BRICK" SH.A.

**VENDIM**
**NR 1 DATE 24.03.2006**
**I KESHILLIT MBIKQYRES I**
**SHOQERISE "MILIS BRICK" SH.A.**

Sot me daten 24.03.2006 ne anetaret e Keshillit Drejtues te Shoqeria"MILIS BRICK"sh.a. Arta Shtjefni , Vera Shijaku e Gjovalin Shtjefi per nevoja te mbarevajtjes se punes dhe bazuar ne Dispozitat e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqerise morem vendimin sa me Poshte:

1- Lirohet nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a. z. Gjovalin Shtjefni.

2-Emerojme Drejtor Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK"sh.a. z.Xhavit Mamaçi duke i dhene te gjitha kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a.

3- Brenda 30 diteve nga marrja e vendimit te mesiperm ngarkohet Drejtori i Ekzekutiv i Shoqerise "MILIS BRICK"sh.a. Xhavit Mamaçi te bej rregjistrimin ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane te Vendimit Nr 1 date 24.03.2006 ne Rregjistrin tregetar prane kesaj Gjykate te ndryshimeve si me siper.

Ky vendim u perpilua ne tre kopje ku njera nga kopjet do te depozitohet ne rregjistrin Tregetar te Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane.

PER KESHILLIN DREJTUES TE SHOQERISE "MILIS BRICK" SH.A

Arta Shtjefni    Vera Shijaku    Gjovalin Shtjefni

Lezhe , me 24.03.2006

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "MILIS BRICK" SH.A.

**V E N D I M**
**NR 2 DATE 24.03.2006**
**I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE AKSIONEREVE TE SHOQERISE "MILIS BRICK" SH.A.**

Sot me daten 24.03.2006 ne Aksioneret e Shoqerise"MILIS BRICK"sh.a. Zef Shtjefni e Shpetim Shijaku per nevoja te mbarevajtjes se punes dhe bazuar ne Dispozitat e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqerise morem vendimin sa me Poshte:

1- Rritjen e Kapitalit themeltar te Shoqerise"MILIS BRICK" sh.a.

2- Caktimin e ekspertes Kontabel Elsa Myslym Balla per te bere vleresimin e rritjes se Kapitalit themeltar ne natyre.

3- Caktimin e ekspertit te vleresimit te pasurise se paluajtshme Muhamet Huti per te bere vleresimin e pasurise.

4- Brenda 30 diteve nga marrja e vendimit te mesiperm ngarkohet Drejtori i Ekzekutiv i Shoqerise "MILIS BRICK"sh.a. Xhavit Mamaçi te bej rregjistrimin ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane te Vendimit Nr 2 date 24.03.2006 ne Rregjistrin tregetar prane kesaj Gjykate te ndryshimeve si me siper.

Ky vendim u perpilua ne tre kopje ku njera nga kopjet do te depozitohet ne rregjistrin Tregetar te Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane.

ORTAKET E SHOQERISE "MILIS BRICK" SH.A

Zef Shtjefni Shpetim Shijaku

Lezhe , me 24.03.2006

Z.. B. Truly
05.04.2006
05 PRRILL 2006

K E R K E S E

**KERKUES** - Xhavit Mamaçi i biri i Sulejmanit i dt 08.01.1951 me banim ne F. Kruje Drejtor Ekzekutiv i Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a..

**ME OBJEKT** - Depozitimin e Vendimit Nr 2 date 24.03.2006 te Shoqerise "MILIS BRICK"sh.a. ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

**BAZA LIGJORE** -Neni 24 i ligjit 7667 dt 28.1.1993 "Per rregjistrimin ne Rregjistrin Tregetar."

**PARA GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR**
**T I R A N E**

**z. Kryetar .**

Une i quajturi Xhavit Mamaçi me detyre drejtor Ekzekutiv I Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. mbi bazen ligjore te mesiperme nga kjo Gjykate kerkoj depozitimin e Vendimit Nr 2 date 24.03.2006 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. ne te cilen eshte vendosur.

Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a. eshte rregjistruar si Person Juridik ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin Nr 32118 date 13.09.2004 ku aksionere themelues te kesaj shoqerie jane Zef Shtjefni me 45% te Aksioneve, Shpetim Shijaku me 35 % te aksioneve dhe Sokol Rakaj me 20% te aksioneve.

Me Vendim te Asamblese se Jashtezakonshme date 17.11.2004 eshte miratuar shitja e aksioneve te Aksionerit z.Sokol Rakaj dy aksionereve z.Zef Shtjefni e z.Shpetim Shijaku te cilet posedojne 55% te aksioneve me nje vlere pre 137.500(njeqind e tridhjete e shtatemije e peseqind)euro z.Zef Shtjefni dhe 45% te aksioneve me nje vlere 112.500( njeqind e dymbedhjetemije e peseqind )Euro z.Shpetim Shijaku.

Gjithashtu eshte vendosur ndryshimi ne Keshillin Mbikeqyres te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a ku ne vend te Vojsava Rakaj emerohet Vera Shijaku

Me vendimin Nr 2 date 24.03.2006 eshte vendosur :

1- Lirohet nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a. z. Gjovalin Shtjefni.

2-Emerojme Drejtor Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK"sh.a. z.Xhavit Mamaçi duke i dhene te gjitha kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a.

3- Rritjen e Kapitalit themeltar te Shoqerise"MILIS BRICK" sh.a.

4- Caktimin e ekspertes Kontabel Ajeta Shkembi per te bere vlresimin e rritjes se Kapitalit themeltar.

5- Brenda 30 diteve nga marrja e vendimit te mesiperm ngarkohet Drejtori i Ekzekutiv i Shoqerise "MILIS BRICK"sh.a. Xhavit Mamaçi te bej rregjistrimin ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane ne Rregjistrin tregetar tre ndryshimeve si me siper.

K E R K U E S I
DREJTORI EKZEKUTIV I "MILIS BRICK" SH.A.
Xhavit Mamaçi

Lezhe, me 24.03.2006

32118/2

# K E R K E S E

**KERKUES** - Xhavit Mamaçi i biri i Sulejmanit i dt 08.01.1951 me banim ne F. Kruje Drejtor Ekzekutiv i Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a..

**ME OBJEKT** - Depozitimin e Vendimin Nr 1 date 24.03.2006 te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise dhe Vendimit Nr 2 date 24.03.2006 te Asamblese se jashtezakonshme te Aksionereve te Shoqerise "MILIS BRICK"sh.a. ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane

**BAZA LIGJORE** -Neni 24 i ligjit 7667 dt 28.1.1993 "Per rregjistrimin ne Rregjistrin Tregetar."

**PARA GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR**
**T I R A N E**

**z. Kryetar .**

Une i quajturi Xhavit Mamaçi me detyre drejtor Ekzekutiv i Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. mbi bazen ligjore te mesiperme nga kjo Gjykate kerkoj depozitimin e Vendimin Nr 1 date 24.03.2006 i Keshillit Mbikqyres te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. dhe Vendimit Nr 2 date 24.03.2006 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. ne te cilen eshte vendosur.

Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a. eshte rregjistruar si Person Juridik ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin Nr 32118 date 13.09.2004 ku aksionere themelues te kesaj shoqerie jane Zef Shtjefni me 45% te Aksioneve, Shpetim Shijaku me 35 % te aksioneve dhe Sokol Rakaj me 20% te aksioneve.

Me Vendim te Asamblese se Jashtezakonshme date 17.11.2004 eshte miratuar shitja e aksioneve te Aksionerit z.Sokol Rakaj dy aksionereve z.Zef Shtjefni e z.Shpetim Shijaku te cilet posedojne 55% te aksioneve me nje vlere pre 137.500(njeqind e tridhjete e shtatemije e peseqind)euro z.Zef Shtjefni dhe 45% te aksioneve me nje vlere 112.500( njeqind e dymbedhjetemije e peseqind )Euro z.Shpetim Shijaku.

Gjithashtu eshte vendosur ndryshimi ne Keshillin Mbikqyres te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a ku ne vend te Vojsava Rakaj emerohet Vera Shijaku.

Me vendimin Nr 1 date 24.03.2006 te Keshillit Mbikqyres eshte vendosur :

1-Lirohet nga detyra e Drejtorit Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a. z. Gjovalin Shtjefni.

2-Emerojme Drejtor Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a. z. Xhavit Mamaçi duke i dhene te gjitha kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv te Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a.

Me vendimin Nr 2 date 24.03.2006 te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. eshte Vendosur

1- Rritjen e Kapitalit themeltar te Shoqerise"MILIS BRICK" sh.a.

2- Caktimin e ekspertes Kontabel Elsa Myslym Balla per te bere vleresimin e rritjes se Kapitalit themeltar ne natyre.

3- Caktimin e ekspertit te vleresimit te pasurise se paluajtshme Muhamet Huti per te bere vleresimin e pasurise.

4- Brenda 30 diteve nga marrja e vendimit te mesiperm ngarkohet Drejtori i Ekzekutiv i Shoqerise "MILIS BRICK"sh.a. Xhavit Mamaçi te bej rregjistrimin ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane ne Rregjistrin tregetar tre ndryshimeve si me siper.

K E R K U E S I
DREJTORI EKZEKUTIV I "MILIS BRICK" SH.A.
Xhavit Mamaçi

Lezhe, me 24.03.2006

3211811

**K E R K E S E**

**KERKUES** - Gjovalin Shtjefni i biri i Dedes i dt 1968 me banim ne Lezhe
Drejtor I Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a..

**ME OBJEKT** - Depozitimin e Vendimit Nr1 date 17.11.2004 te Shoqerise
"MILIS BRICK"sh.a. ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se
Shkalles se Pare Tirane

**BAZA LIGJORE** -Neni 24 i ligjit 7667 dt 28.1.1993
"Per rregjistrimin ne Rregjistrin Tregetar."

**PARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**
**T I R A N E**

**z. Kryetar .**

Une i quajturi Gjovalin Shtjefni me detyre drejtor Ekzekutiv I Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. mbi bazen ligjore te mesiperme nga kjo Gjykate kerkoj depozitimin e Vendimit Nr 1 date 17.11.2004 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a. ne te cilen eshte vendosur.

Shoqeria "MILIS BRICK" sh.a. eshte rregjistruar si Person Juridik ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin Nr 32118 date 13.09.2004 ku aksionere themelues te kesaj shoqerie jane Zef Shtjefni me 45% te Aksioneve, Shpetim Shijaku me 35 % te aksioneve dhe Sokol Rakaj me 20% te aksioneve.

Me Vendim te Asamblese se Jashtezakonshme date 17.11.2004 eshte miratuar shitja e aksioneve te Aksionerit z.Sokol Rakaj dy aksionereve z.Zef Shtjefni e z.Shpetim Shijaku te cilet posedojne 55% te aksioneve me nje vlere pre 137.500(njeqind e tridhjete e shtatemije e peseqind)euro z.Zef Shtjefni dhe 45% te aksioneve me nje vlere 112.500( njeqind e dymbedhjetemije e peseqind )Euro z.Shpetim Shijaku.

Gjithashtu eshte vendosur ndryshimi ne Keshillin Mbikeqyres te Shoqerise "MILIS BRICK" sh.a ku ne vend te Vojsava Rakaj emerohet Vera Shijaku

K E R K U E S I
DREJTORI EKZEKUTIV I "MILIS BRICK" SH.A.
Gjovalin Shtjefni

Lezhe, me 18.11.2004

3218

**K E R K E S E**

09 SHTATOR 2004

| | |
|---|---|
| **KERKUES** | - Gjovalin Shtjefni i biri i Dedes i dt 1968 me banim ne Lezhe Drejtor I Shoqerise "MILIS BREEK" sh.a.. |
| **ME OBJEKT** | - Pranimin e kerkeses per rregjistrimin ne Rregjistrin Tregetar si person juridik te Shoqerise "MILIS BREEK"sh.a. Me seli ne Fushe -Kruje te rrethit Kruje |
| **BAZA LIGJORE** | -Neni 5 i ligjit 7512 dt 10.08.1991 si dhe ligji7638 dt 19.11. 1992"Per Shoqerite tregtare" Ligji 7667 i dt 28.1.1993 "Per rregjistrimin ne Rregjistrin Tregetar." |

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

**PARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**

**T I R A N E**

**z. Kryetar .**

Une i quajturi Gjovalin Shtjefni me banim ne Lezhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbi bazen ligjore te mesiperme nga kjo Gjykate kerkoj

Pranimin e kesaj kerkese dhe rregjistrimin ne Rregjistrin tregetar te Shoqerise "MILIS BREEK" sh.a. te themeluar nga Aksionerat Zef Shtjefni me 45% te Aksioneve, Shpetim Shijaku me 35 % te aksioneve dhe Sokol Rakaj me 20% te aksioneve me aktivitet tregtar me objekt si me poshte:

Ushtrimin e veprimtarise ekonomike tregetare ne fushen e prodhimit te materialeve te ndertimit, sidomos ato qeramike, ndertime te ndryshme, blerje e shitje mallrash me qellim fitimi etj.

Adresa e kesaj shoqerie eshte Fushe Kruje te rrethit Kruje.

Kjo Shoqeri do te vazhdoje aktivitetin per nje kohe mbi 35 vjet.

Kapitali themelor i Shoqerise eshte 250.000 (dyqind e pesedhjetemije) euro e kondvertuar ne leke 31.250.000 (tridhjete e nje milion e dyqind e pesedhjetemije) leke

Drejtor i pare I kesaj Shoqerie do te jete Gjovalin Shtjefni.

Me eksperte kontabel znj. Ajeta Shkembi.

K E R K U E S I

Gjovalin Shtjefni

Lezhe, me 04.09.2004

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE